



- [Të reja](#) [Kush jemi](#) [Historiku](#) [Shërbime](#) [Baza ligjore](#) [Vendndodhjet](#) [Video](#) [Programi i transparencës](#) [Kontakt](#)
- [Denonco Krimin Kibernetik](#) [Drejtoritë Vendore](#) [Policia Kufitare](#) [Policia Rrugore](#) [Donacione](#) [Policimi në Komunitet](#)
- [Përmbledhja Mujore](#) [Për sinjalizimin](#) [Të Guximshëm pa Armë](#)

Breaking News:

Raporti i ngjarjeve, 11 shtator 2025



12/09/2025

Krujë/Finalizohet „Operacioni Policor I Koduar “On Time”

Krujë/Finalizohet operacioni policor i koduar “On time”.

Ndërhyrja në kohë e Policisë parandalon ngjarje kriminale në një familje.

Ushtronte dhunë fizike ndaj bashkëshortes së tij dhe vajzës së tyre të mitur dhe posedonte armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak në banesë, vihet në pranga 44-vjeçari.

Vihet në pranga dhe djali i tij, pasi ka ushtruar dhunë ndaj nënës dhe motrës së tij.

Sekuestrohen 1 armë zjarri kallashnikov, 2 krehra dhe municion luftarak.

Menjëherë pas njoftimit që morën për dhunë fizike dhe kanosje me armë zjarri, në një familje, në lagjen “Derede”, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Krujë organizuan punën dhe shkuan menjëherë në adresën e dhënë.

Si rezultat i veprimeve të shpejta operationale të kryera në kuadër të operacionit të koduar “On Time”, u parandaluan ngjarje të mundshme kriminale në këtë familje, duke arrestuar shtetasit E. M., 44 vjeç dhe A. M., 22 vjeç (babë e bir), të cilët dyshohet se kanë ushtruar dhunë fizike ndaj familjareve të tyre dhe i kanë kanosur me armë zjarri.

Gjatë kontrollit në banesë, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 1 armë zjarri kallashnikov, 2 krehra dhe municion, që i posedonte pa leje, shtetasi E. M.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.



Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month



Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Berat/Finalizohet operacioni policor i koduar “Prova”, arrestohen 3 shtetas

Bëhu pjesë e Policisë së Shtetit, apliko për “Patrullë të Përgjithshme ▶